

LIGJ
Nr. 93/2020

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SHUMËPALËSHE (MLI) PËR ZBATIMIN E MASAVE QË LIDHEN ME MARRËVESHJET TATIMORE PËR PARANDALIMIN E EROZIONIT TË BAZËS DHE TRANSFERIMIT TË FITIMEVE (BEPS)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa shumëpalëshe (MLI) për zbatimin e masave që lidhen me marrëveshjet tatimore për parandalimin e erozionit të bazës dhe transferimit të fitimeve (BEPS), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Republika e Shqipërisë për konventën shumëpalëshe, të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, paraqet rezervat dhe njoftimet sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11565, datë 24.7.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

KONVENTË SHUMËPALËSHE
PËR ZBATIMIN E MASAVE QË LIDHEN ME MARRËVESHJET TATIMORE PËR
PARANDALIMIN E EROZIONIT TË BAZËS DHE TRANSFERIMIT TË FITIMEVE

** Base erosion and profit shifting* (Erozioni i bazës dhe transferimi i fitimeve – BEPS) – u referohen strategjive të planifikimit të tatimeve të përdorura nga shoqëritë shumëkombëshe që shfrytëzojnë boshllëqet dhe mospërputhjet në rregullat tatimore për të zhvendosur artificialisht fitimet në vendndodhje me taksa të ulëta ose pa taksa ku ka pak ose aspak veprimtari ekonomike.

Duke qenë të vetëdijshëm se erozioni i bazës së tatueshme dhe transferimi i fitimeve (në vijim të referuar si “BEPS”) është një çështje emergjente jo vetëm për vendet e industrializuara, por edhe për ekonominë në zhvillim dhe vendet në zhvillim;

Duke njohur rëndësinë e sigurimit të tatimit të fitimeve aty ku kryhen aktivitetet thelbësore ekonomike që gjenerojnë fitime dhe ku krijohet vlera;

Duke mirëpritur paketën e masave të hartuara në kuadër të projektit OECD/G20 BEPS (në

vijim e referuar si “Paketa BEPS e OECD/G20”);

Duke pasur parasysh se paketa BEPS e OECD/G20 ka përfshirë masa të lidhura me marrëveshjen tatimore për të trajtuar disa masa të mospërputhjes hibride, për të parandaluar abuzimin me marrëveshjen, për të trajtuar shmangien artificiale të statusit të selisë së përhershme dhe për të përmirësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

Të vetëdijshëm për nevojën e sigurimit të zbatimit të shpejtë, të koordinuar dhe të qëndrueshëm të masave të BEPS-së që lidhen me marrëveshjen në një kontekst shumëpalësh;

Duke theksuar nevojën për të siguruar që marrëveshjet ekzistuese për shmangien e tatimit të dyfishtë mbi të ardhurat të interpretohen për të eliminuar tatimin e dyfishtë në lidhje me tatimet që mbulohen nga ato marrëveshje, pa krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit ose shmangies tatimore (*duke përfshirë masat e tipit “Treaty-shopping” (Praktika e strukturimit të një biznesi shumëkombësh për të përfutur nga marrëveshjet e taksave më të favorshme të disponueshme në disa juridiksione)*), përfshirë përdorimin abuziv të marrëveshjeve tatimore që synojnë marrjen e lehtësirave të parashikuara në këto marrëveshje për përfitimin jo të drejtpërdrejtë të rezidentëve të juridiksioneve të treta);

Duke njohur nevojën për një mekanizëm efektiv për zbatimin e sinkronizuar dhe efikas të ndryshimeve të pranuar në të gjithë rrjetin e marrëveshjeve ekzistuese për shmangien e tatimit të dyfishtë mbi të ardhurat, pa qenë i nevojshëm rinegoci i çdo marrëveshjeje të tillë;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I

QËLLIMI DHE INTERPRETIMI I TERMAVE

Neni 1

Fusha e zbatimit të Konventës

Kjo Konventë ndryshon të gjitha marrëveshjet për tatimet e mbuluara, siç përcaktohet në nënparagrafin “a”, të paragrafit 1, të nenit 2 (“Interpretimi i termave”).

Neni 2

Interpretimi i termave

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) Termi “Marrëveshje për tatimet e mbuluara” do të thotë një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat (pavarësisht nëse mbulohen apo jo edhe tatimet e tjera):

i. e cila është në fuqi midis dy ose më shumë:

A) Palëve; dhe/ose

B) juridiksioneve ose territoreve që janë palë në një marrëveshje të përshkruar më lart dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjëse një Palë; dhe

ii. në lidhje me të cilën çdo Palë e tillë ka bërë një njoftim te Depozituesi që rendit marrëveshjen, si dhe çdo instrument ndryshimi ose shoqërues (të identifikuar me titull, emrat e palëve, datën e nënshkrimit dhe, nëse është e zbatueshme në kohën e njoftimit, datën e hyrjes në fuqi) si një marrëveshje që ajo dëshiron të mbulohet nga kjo Konventë.

b) Termi “Palë” do të thotë:

i. një shtet për të cilin kjo Konventë është në fuqi sipas nenit 34 (“Hyrja në fuqi”); ose

ii. një juridiksion që ka nënshkruar këtë Konventë në përputhje me nënparagrafin “b” ose “c” të paragrafit 1, të nenit 27 (“Nënshkrimi dhe ratifikimi, pranimi ose miratimi”) dhe për të cilat kjo Konventë është në fuqi sipas nenit 34 (“Hyrja në fuqi”).

c) Termi “Juridiksion kontraktues” do të thotë një palë në një marrëveshje për tatimet e mbuluara.

d) Termi “Nënshkrues” do të thotë një shtet ose juridiksion që ka nënshkruar këtë Konventë, por për të cilin Konventa nuk është ende në fuqi.

2. Për sa i përket zbatimit të kësaj Konvente në çfarëdo kohe nga një Palë, çdo term që nuk është i përkufizuar këtu, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin e dhënë në kohën e marrëveshjes përkatëse për tatimet e mbuluara.

PJESA II MOSPËRPUTHJET HIBRIDE

Neni 3

Subjektet transparente

1. Për qëllimet e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, të ardhurat e realizuara nga/ose nëpërmjet një subjekti ose një marrëveshjeje që trajtohet si tërësisht ose pjesërisht transparent në aspektin fiskal sipas ligjit tatimor të cilitdo juridiksioni kontraktues, do të konsiderohen si të ardhura të një rezidenti të një juridiksioni kontraktues, por vetëm në masën që të ardhurat trajtohen, për qëllime tatimore nga ai juridiksion kontraktues, si të ardhura të një rezidenti të atij juridiksioni kontraktues.

2. Dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që kërkojnë nga një juridiksion kontraktues që të përjashtojë nga tatimi mbi të ardhurat ose të sigurojë një zbritje ose kreditim të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në lidhje me të ardhurat e përfituara nga një rezident i atij juridiksioni kontraktues që mund të tatohet në juridiksionin tjetër kontraktues sipas dispozitave të marrëveshjes për tatime të mbuluara, nuk do të zbatohen në masën që dispozita të tilla lejojnë tatimin nga ai juridiksion tjetër kontraktues vetëm për shkak se të ardhurat janë edhe të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i atij juridiksioni tjetër kontraktues.

3. Në lidhje me marrëveshjet për tatimet e mbuluara për të cilat një ose më shumë palë kanë bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 3, të nenit 11 (“Zbatimi i marrëveshjeve tatimore për kufizimin e të drejtës së një pale për tatimin e rezidentëve të saj”), fjalia e mëposhtme do të shtohet në fund të paragrafit 1: “Në asnjë rast dispozitat e këtij paragrafi nuk do të interpretohen që të ndikojnë në të drejtën e një juridiksioni kontraktues për tatimin e rezidentëve të atij juridiksioni kontraktues”.

4. Paragrafi 1 (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 3) zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara në masën që ato trajtojnë nëse të ardhurat e realizuara nga/ose nëpërmjet subjekteve ose marrëveshjeve që trajtohen si transparente në aspektin fiskal sipas ligjit tatimor të cilitdo juridiksion kontraktues (qoftë nëpërmjet një rregulli të përgjithshëm ose duke identifikuar hollësisht trajtimin e modeleve specifike të fakteve dhe llojet e subjekteve ose marrëveshjeve) do të trajtohen si të ardhura të një rezidenti të një juridiksioni kontraktues.

5. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

- a) të mos zbatojë tërësinë e këtij neni në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;
- b) të mos zbatojë paragrafin 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4;
- c) të mos zbatojë paragrafin 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4 që mohon përfitimet e marrëveshjes në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga/ose nëpërmjet një subjekti ose një marrëveshjeje të themeluar në një juridiksion të tretë;
- d) të mos zbatojë paragrafin 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4 që identifikon hollësisht trajtimin e modeleve specifike të fakteve dhe llojet e subjekteve ose marrëveshjeve;
- e) të mos zbatojë paragrafin 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4 që identifikon hollësisht trajtimin e

modeleve specifike të fakteve dhe llojet e subjekteve ose marrëveshjeve dhe mohon përfitimet e marrëveshjes në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga/ose nëpërmjet një subjekti ose marrëveshjeje të themeluar në një juridiksion të tretë;

f) të mos zbatojë paragrafin 2 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;

g) të zbatojë paragrafin 1 vetëm në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4, që identifikon hollësisht trajtimin e modeleve specifike të fakteve dhe llojet e subjekteve ose marrëveshjeve.

6. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në nënparagrafin “a” ose “b”, të paragrafit 5, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 4 që nuk i nënshtrohet një rezerve sipas nënparagrafëve nga “c” në “e”, të paragrafit 5, dhe nëse po, nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Në rastin e një Pale që ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “g” të paragrafit 5, njoftimi në pajtim me fjalinë e mësipërme do të kufizohet në marrëveshjet për tatimet e mbuluara që janë subjekt i asaj rezerve. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë do të zëvendësohet me dispozitat e paragrafit 1 (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 3) në masën e parashikuar në paragrafin 4. Në rastet e tjera, paragrafi 1 (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 3) do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatime të mbuluara vetëm në atë masë që ato dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 1 (siç mund të ndryshohet nga paragrafi 3).

Neni 4

Subjektet me rezidencë të dyfishtë

1. Kur për shkak të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara një person, i ndryshëm nga një individ, është rezident i më shumë se një juridiksioni kontraktues, autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese do të synojnë të përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët, juridiksionin kontraktues për të cilin ky person do të konsiderohet rezident për qëllimet e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, duke pasur parasysh vendin e tij të menaxhimit efektiv, vendin ku është krijuar ose ndryshe themeluar dhe çdo faktor tjetër përkatës. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, ky person nuk do të ketë të drejtë për ndonjë lehtësi ose përjashtim nga tatimi të ofruar nga marrëveshja për tatimet e mbuluara, përveç në masën dhe në mënyrën që mund të bien dakord autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese.

2. Paragrafi 1 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që parashikojnë rregulla për përcaktimin nëse një person, i ndryshëm nga individ, do të trajtohet si rezident i një prej juridiksioneve kontraktuese në rastet kur ai person do të trajtohej ndryshe si rezident i një ose më shumë se një juridiksioni kontraktues. Megjithatë, paragrafi 1 nuk zbatohet për dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që trajton në mënyrë specifike rezidencën e shoqërive pjesëmarrëse në masat për shoqëritë me listë të dyfishtë.

3. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë tërësinë e këtij neni në marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara;

b) të mos zbatojë tërësinë e këtij neni në marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara, që tashmë trajton rastet kur një person, i ndryshëm nga individ, është rezident i një ose më shumë se një juridiksioni kontraktues, duke kërkuar nga autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese që të synojnë të arrijnë marrëveshje të përbashkët për një juridiksion të vetëm kontraktues ku ai të konsiderohet rezident;

c) të mos zbatojë tërësinë e këtij neni në marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara që tashmë trajton rastet kur një person, i ndryshëm nga individ, është rezident i më shumë se një juridiksioni kontraktues, duke mohuar përfitimet e marrëveshjes, pa u kërkuar autoriteteve kompetente të juridiksioneve kontraktuese që të përpiqen të arrijnë marrëveshje të ndërsjellë për një juridiksion të vetëm kontraktues ku ai të konsiderohet rezident;

d) të mos zbatojë tërësinë e këtij neni në marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara që tashmë trajton raste kur një person, i ndryshëm nga individit, është rezident i më shumë se një juridiksioni kontraktues, duke kërkuar nga autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese që të synojnë të arrijnë marrëveshje të përbashkët për një juridiksion të vetëm kontraktues ku ai të konsiderohet rezident dhe që përcaktojnë trajtimin e atij personi sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara, kur nuk mund të arrihet një marrëveshje e tillë;

e) të zëvendësojë fjalinë e fundit të paragrafit 1 me tekstin e mëposhtëm për qëllimet e marrëveshjes së saj për tatimet e mbuluara: “Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, ky person nuk do të ketë të drejtë për asnjë lehtësi ose përjashtim nga tatimi i ofruar nga marrëveshja për tatimet e mbuluara”;

f) të mos zbatojë tërësinë e këtij neni në marrëveshjen për tatimet e mbuluara me palët që kanë bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “e”.

4. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë, siç përshkruhet në nënparagrafin “a”, të paragrafit 3, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila prej marrëveshjeve për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 2 që nuk i nënshtrohet një rezerve sipas nënparagrafëve “b” deri “d”, të paragrafit 3, dhe nëse është kështu, nenin dhe numrin e paragrafit të çdo dispozite të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë zëvendësohet me dispozitat e paragrafit 1. Në raste të tjera, paragrafi 1 do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në masën që këto dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 1.

Neni 5

Zbatimi i metodave për eliminimin e tatimit të dyfishtë

1. Një Palë mund të zgjedhë të zbatojë paragrafët 2 dhe 3 (Opsioni A), paragrafët 4 dhe 5 (Opsioni B) ose paragrafët 6 dhe 7 (Opsioni C) ose mund të zgjedhë të mos zbatojë asnjë nga opsionet. Kur secili juridiksion kontraktues në një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara zgjedh një Opsion të ndryshëm (ose kur një juridiksion kontraktues zgjedh të zbatojë një Opsion dhe tjetri zgjedh të mos zbatojë asnjë nga Opsionet), Opsioni i zgjedhur nga çdo juridiksion kontraktues do të zbatohet në lidhje me vetë rezidentët e tij.

Opsioni A

2. Dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që ndryshe do të përjashtonin të ardhurat e realizuara ose kapitalin në pronësi të një rezidenti të një juridiksioni kontraktues nga tatimi në atë juridiksion kontraktues, me qëllim eliminimin e tatimit të dyfishtë, nuk do të zbatohen kur juridiksioni tjetër kontraktues zbaton dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara për të përjashtuar këto të ardhura ose këtë kapital nga tatimi ose për të kufizuar normën në të cilën këto të ardhura ose ky kapital mund të tatohen. Në rastin e më të fundit, juridiksioni i parë kontraktues do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat ose kapitalin të atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin e paguar në atë juridiksion tjetër kontraktues. Megjithatë, një zbritje e tillë nuk do të tejkalojë atë pjesë të tatimit të llogaritur para se të jepet zbritja, e cila i atribuohet elementëve të të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohen në atë juridiksion tjetër kontraktues.

3. Paragrafi 2 do të zbatohet për një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, e cila ndryshe do të kërkonte një juridiksion kontraktues për të përjashtuar të ardhurat ose kapitalin e përshkruar në atë paragraf.

Opsioni B

4. Dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që ndryshe do të përjashtonin të ardhurat e realizuara nga një rezident i një juridiksioni kontraktues nga tatimi në atë juridiksion kontraktues, me qëllim eliminimin e tatimit të dyfishtë pasi këto të ardhura trajtohen si një dividend nga ai juridiksion kontraktues, nuk do të zbatohen kur këto të ardhura të shkaktojnë një zbritje, me qëllimin e përcaktimit të fitimeve të tatueshme të një rezidenti të juridiksionit tjetër

kontraktues sipas ligjeve të atij juridiksioni tjetër kontraktues. Në një rast të tillë, juridiksioni i parë kontraktues do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat i atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e paguar në atë juridiksion tjetër kontraktues. Megjithatë, një zbritje e tillë nuk do të tejkalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat, të llogaritur para se të jepet zbritja, e cila i atribuohet këtyre të ardhurave që mund të tatohen në atë juridiksion tjetër kontraktues.

5. Paragrafi 4 do të zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara, e cila ndryshe do të kërkonte një juridiksion kontraktues për të përjashtuar të ardhurat e përshkruara në atë paragraf.

Opsioni C

6. a) Kur një rezident i një juridiksioni kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapital që mund të tatohet në juridiksionin tjetër kontraktues në përputhje me dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara (me përjashtim të rasteve kur këto dispozita lejojnë tatimin nga ai juridiksion tjetër kontraktues vetëm për shkak se të ardhurat janë gjithashtu të ardhura që rrjedhin nga një rezident i atij juridiksioni tjetër kontraktues), juridiksioni i parë kontraktues do të lejojë:

i. si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në atë juridiksion tjetër kontraktues;

ii. si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin e paguar në atë juridiksion tjetër kontraktues.

Megjithatë, kjo zbritje nuk do të tejkalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose tatimin mbi kapitalin, të llogaritur para dhënies së zbritjes që i atribuohet të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në atë juridiksion tjetër kontraktues.

b) Kur në përputhje me çfarëdo dispozite të marrëveshjes për tatimet e mbuluara, të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i një juridiksioni kontraktues përjashtohen nga tatimi në atë juridiksion kontraktues, ai juridiksion kontraktues, megjithatë, mund të marrë parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të atij rezidenti.

7. Paragrafi 6 zbatohet në vend të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që, për qëllime të eliminimit të tatimit të dyfishtë, kërkon që një juridiksion kontraktues të përjashtojë nga tatimi në atë juridiksion kontraktues të ardhurat e realizuara ose kapitalin që zotërohet nga një rezident i atij juridiksioni kontraktues që, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, mund të tatohet në juridiksionin tjetër kontraktues.

8. Një palë që nuk vendos të zbatojë një Opsion sipas paragrafit 1, mund të rezervojë të drejtën që të mos zbatojë në tërësi këtë nen në lidhje me një ose më shumë marrëveshje për tatimet e mbuluara (ose në lidhje me të gjitha marrëveshjet për tatimet e mbuluara).

9. Një palë që nuk zgjedh të zbatojë Opsionin C mund të rezervojë të drejtën, në lidhje me një ose më shumë marrëveshje për tatimet e mbuluara (ose në lidhje me të gjitha marrëveshjet për tatimet e mbuluara), të mos lejojë që juridiksioni tjetër kontraktues (juridiksionet e tjera kontraktuese) të zbatojë (të zbatojnë) Opsionin C.

10. Secila palë që zgjedh të zbatojë një Opsion sipas paragrafit 1 duhet të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e Opsionit nga ana e saj. Ky njoftim do të përfshijë gjithashtu:

a) në rastin e një Pale që zgjedh të zbatojë Opsionin A, listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 3, si dhe nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë;

b) në rastin e një Pale që zgjedh të zbatojë Opsionin B, listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 5, si dhe nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë;

c) në rastin e një Pale që zgjedh të zbatojë Opsionin C, listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 7, si dhe nenin dhe numrin e paragrafit të çdo dispozite të tillë.

Një opsion do të zbatohet në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara vetëm kur Pala që ka zgjedhur të zbatojë atë Opsion ka bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë dispozitë.

PJESA III ABUZIMI ME MARRËVESHJEN

Neni 6

Qëllimi i një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara

1. Marrëveshja për tatimet e mbuluara do të modifikohet dhe do të përfshijë tekstin e preambulës si vijon:

“Duke synuar eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet që mbulohen nga kjo marrëveshje, pa krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit ose shmangies tatimore (duke përfshirë marrëveshjet e tipit *treaty-shopping*, që synojnë marrjen e lehtësirave të parashikuara në këtë marrëveshje për përfitimin e tërthortë të rezidentëve të juridiksioneve të treta)”.

2. Teksti i përshkruar në paragrafin 1 do të përfshihet në një marrëveshje për tatimet e mbuluara në vend të ose në mungesë të tekstit të preambulës të marrëveshjes për tatimet e mbuluara, duke iu referuar një qëllimi për të eliminuar tatimin e dyfishtë, pavarësisht nëse ai tekst i referohet apo jo qëllimit për të mos krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar.

3. Një Palë mund të zgjedhë, gjithashtu, të përfshijë tekstin e preambulës në vijim në lidhje me marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara që nuk përmbajnë tekstin e preambulës, duke iu referuar një dëshire për të zhvilluar një marrëdhënie ekonomike ose për të rritur bashkëpunimin në çështjet tatimore:

“Duke dëshiruar zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre ekonomike dhe rritjen e bashkëpunimit të tyre në çështjet tatimore”.

4. Një Palë mund të rezervojë të drejtën që paragrafi 1 të mos zbatohet në marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara që përmbajnë tashmë tekstin e preambulës që përshkruan qëllimin e juridiksioneve kontraktuese për të eliminuar tatimin e dyfishtë, pa krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar, pavarësisht nëse ai tekst kufizohet në rastet e evazionit ose shmangies tatimore (duke përfshirë marrëveshjet e tipit *treaty-shopping*, që synojnë përfitimin e lehtësirave të parashikuara në këtë marrëveshje për përfitimin e tërthortë të rezidentëve të juridiksioneve të treta) ose zbatohet më gjerësisht.

5. Secila Palë do të njoftojë Depozituesin, nëse secila prej marrëveshjeve për tatimet e mbuluara, përveç atyre që janë në kuadër të një rezerve sipas paragrafit 4, përmban gjuhën e preambulës së përshkruar në paragrafin 2 dhe nëse po, tekstin e paragrafit përkatës të preambulës. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë gjuhë të preambulës, teksti i preambulave zëvendësohet me tekstin e përshkruar në paragrafin 1. Në raste të tjera, teksti i përshkruar në paragrafin 1 do të përfshihet gjithashtu përveç gjuhës ekzistuese të preambulës.

6. Secila Palë që zgjedh të zbatojë paragrafin 3, do të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e saj. Ky njoftim do të përfshijë gjithashtu listën e marrëveshjeve për tatimet e mbuluara që nuk përmbajnë tekstin e preambulës që i referohet një dëshire për të zhvilluar një bashkëpunim ekonomik ose për të rritur bashkëpunimin në çështjet tatimore. Teksti i përshkruar në paragrafin 3 do të përfshihet në një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë zgjedhur të zbatojnë atë paragraf dhe kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara.

Neni 7

Parandalimi i abuzimit me marrëveshjen

1. Pavarësisht nga çdo dispozitë e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, një përfitim sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara nuk do të jepet në lidhje me një zë të të ardhurave ose

kapitalit nëse është e arsyeshme të konkludohet, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse, që marrja e atij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni që ka rezultuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në atë përfitim, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet se dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të marrëveshjes për tatimet e mbuluara.

2. Paragrafi 1 do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që mohojnë të gjitha ose një pjesë të përfitimeve që do të siguroheshin ndryshe sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara, ku qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të çfarëdo marrëveshjeje ose transaksioni apo çdo personi të lidhur me një marrëveshje ose transaksion, ishte marrja e atyre përfitimeve.

3. Një palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 15, mund të zgjedhë, gjithashtu, të zbatojë paragrafin 4 në lidhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara.

4. Kur një përfitim në bazë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara i është mohuar një personi sipas dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga kjo Konventë) që mohojnë të gjitha ose një pjesë të përfitimeve që do të siguroheshin ndryshe sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara, ku qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të çfarëdo marrëveshjeje ose transaksioni apo çdo personi që lidhet me një marrëveshje ose transaksion, ishte marrja e atyre përfitimeve, autoriteti kompetent i juridiksionit kontraktues që do të kishte dhënë këtë përfitim, megjithatë do ta trajtojë atë person si një person që ka të drejtë për këtë përfitim ose për përfitime të ndryshme në lidhje me një zë të veçantë të të ardhurave ose kapitalit, nëse ky autoritet kompetent, me kërkesë të atij personi dhe pas shqyrtimit të fakteve dhe rrethanave përkatëse, përcakton se përfitime të tilla do të ishin dhënë për atë person në mungesë të transaksionit ose marrëveshjes. Autoriteti kompetent i juridiksionit kontraktues, të cilit i është drejtuar një kërkesë sipas këtij paragrafi nga një rezident i juridiksionit tjetër kontraktues, duhet të konsultohet me autoritetin kompetent të atij juridiksioni tjetër kontraktues para se të refuzohet kërkesa.

5. Paragrafi 4 do të zbatohet për dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara (siç mund të ndryshohet nga kjo Konventë) që mohojnë të gjitha ose një pjesë të përfitimeve që do të siguroheshin ndryshe në marrëveshjen për tatimet e mbuluara, nëse qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni apo çdo personi që lidhet me një marrëveshje ose transaksion, ishte marrja e atyre përfitimeve.

6. Një Palë mund të zgjedhë gjithashtu të zbatojë dispozitat e paragrafëve nga 8 deri 13 (në vijim referuar si: “Parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve”) në marrëveshjen e saj për tatimet e mbuluara, duke bërë njoftimin e përshkruar në nënparagrafin “c”, të paragrafit 17. Parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve do të zbatohet në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë zgjedhur ta zbatojnë atë.

7. Në rastet kur disa, por jo të gjitha juridiksionet kontraktuese në një marrëveshje për tatimet e mbuluara zgjedhin të zbatojnë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve sipas paragrafit 6, atëherë, pavarësisht nga dispozitat e atij paragrafi, parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve do të zbatohet në lidhje me dhënien e përfitimeve sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara:

a) nga të gjitha juridiksionet kontraktuese, nëse të gjitha juridiksionet kontraktuese që nuk zgjedhin, sipas paragrafit 6, të zbatojnë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve, bien dakord për një zbatim të tillë, duke zgjedhur të zbatojnë këtë nënparagraf dhe duke njoftuar Depozituesin në përputhje me rrethanat; ose

b) vetëm nga juridiksionet kontraktuese që zgjedhin të zbatojnë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve, nëse të gjitha juridiksionet kontraktuese që nuk zgjedhin, sipas paragrafit 6, të zbatojnë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve, bien dakord për një aplikim të tillë, duke zgjedhur të zbatojnë këtë nënparagraf dhe duke njoftuar Depozituesin në përputhje me rrethanat.

Parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve

8. Përveç kur parashikohet ndryshe në parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve, një rezident i një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara nuk do të ketë të drejtë për një përfitim që do të jepet ndryshe nga marrëveshja për tatimet e mbuluara, përveç një përfitimi sipas dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara:

a) të cilat përcaktojnë rezidencën e një personi të ndryshëm nga një individ, i cili është rezident i më shumë se një juridiksioni kontraktues për shkak të dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara që përcaktojnë një rezident të një juridiksioni kontraktues;

b) të cilat parashikojnë që një juridiksion kontraktues do t'i japë një ndërmarrjeje të atij juridiksioni kontraktues një rregullim korrespondues pas një rregullimi fillestar të bërë nga juridiksioni tjetër kontraktues, në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara, në shumën e tatimit të ngarkuar në juridiksionin e parë kontraktues mbi fitimet e një ndërmarrjeje të lidhur me të; ose

c) të cilat lejojnë rezidentët e një juridiksioni kontraktues të kërkojnë që autoriteti kompetent i këtij juridiksioni kontraktues të marrë në konsideratë rastet e tatimit që nuk janë në përputhje me marrëveshjen për tatimet e mbuluara,

Përveç nëse ky rezident është një “person i kualifikuar”, siç përcaktohet në paragrafin 9, në kohën kur përfitimi do të jepet.

9. Një rezident i një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara do të jetë person i kualifikuar në një kohë kur një përfitim do të ishte dhënë ndryshe nga marrëveshja për tatimet e mbuluara, nëse në atë kohë rezidenti është:

a) një individ;

b) ai juridiksion kontraktues ose nënndarje politike ose autoritet lokal i tij, ose një agjenci ose institucion i një juridiksioni të tillë kontraktues, nënndarjeje politike ose autoritet lokal;

c) një shoqëri ose subjekt tjetër, nëse klasa kryesore e aksioneve të saj tregtohet rregullisht në një ose më shumë bursa të njohura;

d) një person, përveçse një individ, që:

i. është një organizatë jofitimprurëse e një lloji që pranohet nga juridiksionet kontraktuese nëpërmjet një shkëmbimi notash diplomatike; ose

ii. është një subjekt ose strukturë e themeluar në atë juridiksion kontraktues që trajtohet si një person i veçantë sipas ligjeve tatimore të atij juridiksioni kontraktues; dhe:

A) që është themeluar dhe ushtron veprimtarinë ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për të administruar ose siguruar përfitime të daljes në pension dhe përfitime ndihmëse ose rastësore për individët dhe që rregullohet si i tillë nga ai juridiksion kontraktues ose një nga nënndarjet e tij politike, ose autoritetet lokale; ose

B) që është themeluar dhe ushtron veprimtarinë ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për të investuar fonde në dobi të subjekteve ose strukturave të referuara në nënndarjen A);

e) një person i ndryshëm nga një individ, nëse për të paktën gjysmën e ditëve të një periudhe dymbëdhjetë mujore që përfshin kohën kur përfitimi do të ishte akorduar, personat që janë rezidentë të atij juridiksioni kontraktues dhe që kanë të drejta për përfitimet e marrëveshjes për tatimet e mbuluara sipas nënparagrafëve nga “a” deri “d” zotërojnë, drejtpërdrejt ose jo, të paktën 50 për qind të aksioneve të personit.

10. a) Një rezident i një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara do të ketë të drejtën e përfitimeve nga marrëveshja për tatimet e mbuluara në lidhje me një zë të ardhurash që rrjedhin nga juridiksioni tjetër kontraktues, pavarësisht nëse rezidenti është person i kualifikuar, nëse rezidenti është i angazhuar në drejtimin aktiv të një biznesi në juridiksionin e parë kontraktues dhe të ardhurat që rrjedhin nga juridiksioni tjetër kontraktues rrjedhin ose janë të rastësishme për atë biznes. Për qëllime të parashikimit të thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve, termi “drejtim aktiv i një biznesi” nuk përfshin asnjë nga aktivitetet e mëposhtme ose kombinimet e tyre:

i. ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri e tipit *holding*;

ii. sigurimin e mbikëqyrjes ose administrimit të përgjithshëm të një grupi shoqërisë;
iii. sigurimin e financimit në kuadër të grupit (duke përfshirë menaxhimin e likuiditeteve); ose
iv. kryerjen ose menaxhimin e investimeve, përveçse kur këto aktivitete kryhen nga një bankë, shoqëri sigurimesh ose ndërmjetës letrash me vlerë i regjistruar në cilësinë e kuadrit të aktivitetit të tij të zakonshëm të biznesit.

b) Nëse një rezident i një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara realizon një zë të ardhurash nga një aktivitet biznesi i kryer nga ai rezident në juridiksionin tjetër kontraktues ose realizon një zë të ardhurash që lind në juridiksionin tjetër kontraktues nga një person me të cilin ka lidhje, kushtet e përshkruara në nënparagrafin “a” do të konsiderohen se janë plotësuar në lidhje me atë zë vetëm nëse aktiviteti i biznesit i kryer nga rezidenti në juridiksionin e parë kontraktues të përmendur me të cilin është e lidhur e ardhura është thelbësor në lidhje me të njëjtën veprimtari ose me një aktivitet biznesi plotësues në juridiksionin tjetër kontraktues të kryer nga rezidenti ose një person me të cilin ka lidhje. Nëse një veprimtari biznesi është thelbësore për qëllimet e këtij nënparagrafi, do të përcaktohet në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

c) Për qëllimet e zbatimit të këtij paragrafi, aktivitetet e kryera nga personat midis të cilëve ekzistojnë lidhje, duke iu referuar një rezidenti të një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara, do të konsiderohen se kryhen nga një rezident i tillë.

11. Një rezident i një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara që nuk është person i kualifikuar, ka të drejtë gjithashtu për një përfitim që ndryshe do të akordohej nga marrëveshja për tatimet e mbuluara në lidhje me një zë të ardhurash nëse, për të paktën gjysmën e ditëve të çdo periudhe dymbëdhjetë mujore që përfshin kohën kur ndryshe përfitimi do të ishte akorduar, personat që janë përfitues të barasvlershëm zotërojnë, drejtpërdrejt ose jo, të paktën 75 për qind të interesave përfituese të rezidentit.

12. Nëse një rezident i një juridiksioni kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara nuk është as person i kualifikuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 9, as nuk ka të drejtën e përfitimeve sipas paragrafit 10 ose 11, autoriteti kompetent i juridiksionit tjetër kontraktues, megjithatë, mund të japë përfitimet e marrëveshjes për tatimet e mbuluara ose përfitime në lidhje me një zë të veçantë të ardhurash, duke marrë parasysh objektin dhe qëllimin e marrëveshjes për tatimet e mbuluara, por vetëm nëse ai rezident i provon në mënyrë të pranueshme këtij autoriteti kompetent se as selia e tij, përvetësimi ose mirëmbajtja e saj, as kryerja e veprimeve të tij, nuk kishte si një nga qëllimet kryesore marrjen e përfitimeve sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara. Para pranimit ose mohimit të një kërkesë të bërë sipas këtij paragrafi nga një rezident i një juridiksioni kontraktues, autoriteti kompetent i juridiksionit tjetër kontraktues të cilit i është bërë kërkesa, duhet të konsultohet me autoritetin kompetent të juridiksionit të parë kontraktues të lartpërmendur.

13. Për qëllimet e parashikimit të thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve:

a) termi “bursë e njohur” do të thotë:

i. çdo bursë e krijuar dhe e rregulluar si e tillë sipas ligjeve të juridiksionit kontraktues; dhe

ii. çdo bursë tjetër e miratuar nga autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese;

b) termi “klasë kryesore e aksioneve” do të thotë klasa ose klasat e aksioneve të një shoqërie që përfaqëson shumicën e votës dhe vlerës së përgjithshme të shoqërisë ose klasës ose klasave të interesave përfituese të një subjekti, i cili përfaqëson në tërësi një shumicë votash dhe vlerë të përgjithshme të subjektit;

c) termi “përfitues ekuivalent” do të thotë çdo person që do të kishte të drejtë për përfitime në lidhje me një zë të ardhurave të akorduara nga një juridiksion kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara sipas ligjit vendas të atij juridiksioni kontraktues, marrëveshje për tatimet e mbuluara ose çfarëdo instrumenti tjetër ndërkombëtar, të cilat janë ekuivalente ose më të favorshme se përfitimet që do t'i akordohen atij zëri të ardhurash sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara; për qëllime të përcaktimit nëse një person është përfitues ekuivalent në lidhje me dividendët, do të konsiderohet se personi mban të njëjtin kapital të shoqërisë që paguan

dividendët si kapitali që ka shoqëria që pretendon përfitimin në lidhje me dividendët;

d) në lidhje me subjektet që nuk janë shoqëri, termi “aksione” do të thotë interesat që janë të krahasueshme me aksionet;

e) dy persona do të jenë “persona që kanë lidhje me njëri-tjetrin”, nëse njëri prej tyre zotëron drejtpërdrejt ose jo, të paktën 50 për qind të interesit përfitues te personi tjetër (ose në rastin e një shoqërie, të paktën 50 për qind të votave të përgjithshme dhe vlerës së aksioneve të shoqërisë) ose një person tjetër zotëron, drejtpërdrejt ose jo, të paktën 50 për qind të interesit përfitues (ose, në rastin e një shoqërie, të paktën 50 për qind të totalit të votave dhe të vlerës së aksioneve të shoqërisë) te çdo person; në çdo rast, personi duhet të lidhet me një tjetër, nëse në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave përkatëse, njëri ka kontrollin e tjetrit ose të dy janë nën kontrollin e të njëjtit person ose personave të njëjtë.

14. Parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve do të zbatohet në vend të ose në mungesë të dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara që do të kufizonin përfitimet e marrëveshjes për tatimet e mbuluara (ose që do të kufizonin përfitime të ndryshme nga një përfitim sipas dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara në lidhje me rezidencën, ndërmarrjet të ndërlidhura ose mosdiskriminimin ose një përfitim që nuk kufizohet vetëm për rezidentët e një juridiksioni kontraktues) vetëm për një rezident që kualifikohet për përfitime të tilla, duke përmbytur një ose më shumë teste katërkohë.

15. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë paragrafin 1 në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara në bazë të faktit që ajo synon të miratojë një kombinim të një parashikimi të hollësishëm për kufizimin e përfitimeve dhe çfarëdo rregulli për të trajtuar strukturat e mënyrave të financimit ose një test qëllimi kryesor, duke përmbytur standardin minimal për parandalimin e abuzimit me marrëveshjen sipas Paketës BEPS të OECD/G20; në raste të tilla, juridiksionet kontraktuese do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje reciprokisht të kënaqshme që plotëson standardin minimal;

b) të mos zbatojë paragrafin 1 (dhe paragrafin 4, në rastin e një Pale që ka zgjedhur të zbatojë atë paragraf) në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbyjnë dispozita që mohojnë të gjitha përfitimet që do të jepeshin ndryshe në marrëveshjen për tatimet e mbuluara, ku qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni ose të çdo personi që lidhet me një marrëveshje ose transaksion, ishte marrja e atyre përfitimeve;

c) Parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që tashmë përmbyjnë dispozitat e përshkruara në paragrafin 14.

16. Duke përjashtuar situatat kur parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve zbatohet në lidhje me dhënien e përfitimeve sipas një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara nga një ose më shumë Palë në përputhje me paragrafin 7, një Palë që zgjedh, në përputhje me paragrafin 6, të zbatojë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve, mund të rezervojë të drejtën të mos zbatojë në tërësi këtë nen në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara, për të cilat një ose më shumë nga juridiksionet e tjera kontraktuese nuk kanë zgjedhur të zbatojnë parashikimin e thjeshtuar për sigurimin e përfitimeve. Në raste të tilla, juridiksionet kontraktuese do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje reciprokisht të pranueshme, e cila plotëson standardin minimal për parandalimin e abuzimit me marrëveshjen sipas paketës BEPS të OECD/G20.

17. a) Secila Palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 15, duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila nga marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara që nuk i nënshtrohet një rezerve të përshkruar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 15, përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 2, dhe nëse po, nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë zëvendësohet me dispozitat e paragrafit 1 (dhe në rastet kur është e zbatueshme, paragrafi 4). Në raste të tjera, paragrafi 1 (dhe në rastet kur është e zbatueshme, paragrafi 4) zëvendëson dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në atë masë që ato dispozita nuk janë në përputhje me paragrafin 1 (dhe kur është e zbatueshme, paragrafi 4). Një Palë që kryen një njoftim sipas

këtij nënparagrafi mund të përfshijë gjithashtu një deklaratë që, derisa një Palë e tillë pranon vetëm zbatimin e paragrafit 1 si masë të përkohshme, ajo synon në rastet kur është e mundur, të miratojë një parashikim për kufizimin e përfitimeve, përveç ose në vend të paragrafit 1, nëpërmjet negociatave dypalëshe.

b) Secila Palë që zgjedh të zbatojë paragrafin 4 do të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e saj. Paragrafi 4 zbatohet për një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë.

c) Secila Palë që zgjedh të zbatojë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve në përputhje me paragrafin 6 do të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e saj. Përveç rasteve kur ajo Palë ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “c”, të paragrafit 15, ai njoftim duhet të përfshijë gjithashtu listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 14, si dhe nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë.

d) Secila Palë që nuk zgjedh të zbatojë parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve sipas paragrafit 6, por zgjedh të zbatojë nënparagrafin “a” ose “b” të paragrafit 7, duhet të njoftojë Depozituesin për zgjedhjen e nënparagrafit. Përveç rasteve kur një Palë e tillë ka bërë rezervën e përshkruar në nënparagrafin “c”, të paragrafit 15, ky njoftim duhet të përfshijë gjithashtu listën e marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara që përmbajnë një dispozitë të përshkruar në paragrafin 14, si dhe nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë.

e) Në rastin kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim sipas nënparagrafit “c” ose “d” në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, ajo dispozitë zëvendësohet me parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve. Në raste të tjera, parashikimi i thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve do të zëvendësojë dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara vetëm në atë masë që ato dispozita nuk janë në përputhje me parashikimin e thjeshtuar për kufizimin e përfitimeve.

Neni 8

Transaksionet e transferimit të dividendëve

1. Dispozitat e një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që përjashtojnë nga tatimi dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e një juridiksioni kontraktues ose që kufizojnë përqindjen në të cilën mund të tatohen këta dividendë, me kusht që pronari përfitues ose përfituesi të jetë shoqëri rezidente e juridiksionit tjetër kontraktues dhe që zotëron, mban ose kontrollon më shumë se një sasi të caktuar të kapitalit, aksioneve, stokut, fuqisë votuese, të drejtave të votimit ose interesave të ngjashme pronësore të shoqërisë që paguan dividendët, do të zbatohen vetëm nëse kushtet e pronësisë që përshkruhen në këto dispozita plotësohen gjatë një periudhe prej 365 ditësh që përfshin ditën e pagesës së dividendëve (për qëllimin e llogaritjes së asaj periudhe, nuk do të merren parasysh ndryshimet e pronësisë që do të rezultojnë drejtpërdrejt nga një riorganizim korporativ, si p.sh. shkrirja ose riorganizimi ndarës i shoqërisë që mban aksionet ose që paguan dividendët).

2. Periudha minimale e mbajtjes e parashikuar në paragrafin 1 zbatohet në vend të ose në mungesë të një periudhe mbajtëse minimale në dispozitat e marrëveshjes për tatimet e mbuluara të përshkruara në paragrafin 1.

3. Një Palë mund të rezervojë të drejtën:

a) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara;
b) të mos zbatojë në tërësi këtë nen në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara deri në masën që dispozitat e përshkruara në paragrafin 1 tashmë përfshijnë:

i. një periudhë mbajtëse minimale;

ii. një periudhë mbajtëse minimale më e shkurtër se një periudhë prej 365 ditësh; ose

iii. një periudhë minimale mbajtëse më e gjatë se një periudhë prej 365 ditësh.

4. Secila Palë që nuk ka bërë një rezervë të përshkruar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 3,

duhet të njoftojë Depozituesin nëse secila prej marrëveshjeve për tatimet e mbuluara përmban një dispozitë të përshkruar në paragrafin 1 që nuk i nënshtrohet një rezerve të përshkruar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 3, dhe nëse po, nenin dhe numrin e paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Paragrafi 1 do të zbatohet në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeve për tatimet e mbuluara vetëm kur të gjitha juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë në lidhje me atë dispozitë.

Neni 9

Fitimet kapitale nga tjetërsimi i aksioneve ose interesat e subjekteve, vlera e të cilave përfaqësohet kryesisht nga pasuritë e paluajtshme

1. Dispozitat e një marrëveshjeve për tatimet e mbuluara, sipas të cilave fitimet e marra nga një rezident i një juridiksioni kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose i të drejtave të tjera të pjesëmarrjes në një subjekt mund të tatohen në juridiksionin tjetër kontraktues me kusht që më shumë se një pjesë e caktuar e vlerës së këtyre aksioneve apo të drejtave të vijnë nga pasuria e paluajtshme që ndodhet në atë juridiksion tjetër kontraktues (ose me kusht që më shumë se një pjesë e caktuar e pasurisë së subjektit të përbëhet nga kjo pasuri e paluajtshme):

a) do të zbatohen nëse arrihet pragu i vlerës përkatëse në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit; dhe

b) do të zbatohen për aksionet ose interesat e krahasueshme, siç janë interesat në partneritet ose trust (në atë masë që aksionet ose interesat e tilla tashmë nuk janë mbuluar), përveç çdo aksioni ose të drejte të mbuluar tashmë nga dispozitat.

2. Periudha e parashikuar në nënparagrafin “a”, të paragrafit 1, do të zbatohet në vend të ose në mungesë të një periudhe kohore për të përcaktuar nëse është arritur pragu i vlerës përkatëse në dispozitat e një marrëveshjeve për tatimet e mbuluara, të përshkruar në paragrafin 1.

3. Gjithashtu, një Palë mund të zgjedhë të zbatojë paragrafin 4 në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

4. a) Vendimi i arbitrazhit në lidhje me çështjet e paraqitura në arbitrazh do të zbatohet nëpërmjet marrëveshjes së ndërsjellë/me mirëkuptim në lidhje me çështjen e përmendur në paragrafin 1. Vendimi i arbitrazhit do të jetë i formës së prerë.

b) Vendimi i arbitrazhit do të jetë i detyrueshëm për të dy juridiksionet kontraktuese, përveç rasteve të mëposhtme:

i. nëse një person i prekur drejtpërdrejt nga çështja nuk pranon marrëveshjen e përbashkët që zbaton vendimin e arbitrazhit. Në një rast të tillë, çështja nuk do të jetë e përshtatshme për asnjë shqyrtim të mëtejshëm nga autoritetet kompetente. Marrëveshja e ndërsjellë që zbaton vendimin e arbitrazhit për çështjen nuk do të konsiderohet e pranuar nga një person i prekur drejtpërdrejt nga çështja, nëse një person i prekur drejtpërdrejt nga çështja nuk tërheq, brenda 60 ditëve nga data në të cilën njoftimi i marrëveshjes së përbashkët i dërgohet personit, të gjitha çështjet e zgjidhura në marrëveshjen e ndërsjellë, duke zbatuar vendimin e arbitrazhit nga shqyrtimi nga çdo gjykatë ose gjykatë administrative ose nuk ndërpret çfarëdo proces gjyqësor ose administrativ në lidhje me këto çështje në përputhje me atë marrëveshje të përbashkët/marrëveshje me mirëkuptim.

ii. nëse një vendim i formës së prerë i gjykatave të njërit prej juridiksioneve kontraktuese konstaton se vendimi i arbitrazhit është i pavlefshëm. Në një rast të tillë, kërkesa për arbitrazh sipas paragrafit 1 konsiderohet se nuk është bërë dhe procesi i arbitrazhit konsiderohet të mos jetë realizuar (përveç për qëllimet e neneve 21 (“Konfidencialiteti i procedurave të arbitrazhit”) dhe 25 (“Shpenzimet e procedurës së arbitrazhit”). Në një rast të tillë, mund të bëhet një kërkesë e re për arbitrazh, me përjashtim të rasteve kur autoritetet kompetente bien dakord që një kërkesë e tillë e re nuk duhet të lejohet.

iii. nëse një person i prekur drejtpërdrejt nga çështja, ndjek çështje gjyqësore për çështje të cilat janë zgjidhur me marrëveshjen e ndërsjellë, duke zbatuar vendimin e arbitrazhit në çfarëdo gjykatë ose gjykatë administrative.

5. Autoriteti kompetent që ka marrë kërkesën fillestare për një procedurë marrëveshjeje të ndërsjellë/me mirëkuptim, siç përshkruhet në nënparagrafin “a”, të paragrafit 1, brenda dy muajve kalendarikë nga marrja e kërkesës:

a) do t'i dërgojë personit që ka paraqitur çështjen, një njoftim se ka pranuar kërkesën; dhe

b) do të dërgojë një njoftim për atë kërkesë, së bashku me një kopje të kërkesës, tek autoriteti kompetent i juridiksionit tjetër kontraktues.

6. Brenda tre muajve kalendarikë pasi një autoritet kompetent merr kërkesën për një procedurë të marrëveshjes së ndërsjellë (ose një kopje të saj nga autoriteti kompetent i juridiksionit tjetër kontraktues) autoriteti, ose:

a) do të njoftojë personin që ka paraqitur çështjen dhe autoritetin tjetër kompetent se ka marrë informacionin e nevojshëm për të ndërmarrë shqyrtimin thelbësor të çështjes; ose

b) do të kërkojë informacion shtesë nga ai person për këtë qëllim.

7. Kur në përputhje me nënparagrafin “b”, të paragrafit 6, një ose të dyja autoritetet kompetente kanë kërkuar nga personi i cili ka paraqitur çështjen, të japë informacion shtesë të nevojshëm për të ndërmarrë shqyrtimin thelbësor të rastit, autoriteti kompetent që kërkoj informacion shtesë, brenda tri muajve kalendarikë nga marrja e informacioneve shtesë nga ai person, do të njoftojnë atë person dhe autoritetin tjetër kompetent:

a) se ka marrë informacionin e kërkuar; ose

b) se disa nga informacionet e kërkuara ende mungojnë.

8. Në rastin kur asnjë autoritet kompetent nuk ka kërkuar informacione shtesë sipas nënparagrafit “b”, të paragrafit 6, data e fillimit e referuar në paragrafin 1 do të jetë më herët se:

a) data në të cilën të dyja autoritetet kompetente kanë njoftuar personin që ka paraqitur rastin në pajtim me nënparagrafin “a”, të paragrafit 6; dhe

b) data që është tre muaj kalendarikë pas njoftimit të autoritetit kompetent të juridiksionit tjetër kontraktues në pajtim me nënparagrafin “b”, të paragrafit 5.

9. Kur është kërkuar informacion shtesë në përputhje me nënparagrafin “b”, të paragrafit 6, data e fillimit e referuar në paragrafin 1 do të jetë më herët se:

a) data e fundit në të cilën autoritetet kompetente që kanë kërkuar informacione shtesë kanë njoftuar personin që ka paraqitur rastin dhe autoritetin tjetër kompetent në pajtim me nënparagrafin “a”, të paragrafit 7; dhe

b) data që është tre muaj kalendarikë pasi të dyja autoritetet kompetente kanë marrë të gjitha informacionet e kërkuara nga cildo autoritet kompetent nga personi që ka paraqitur rastin.

Megjithatë, nëse një ose të dy autoritetet kompetente dërgojnë njoftimin e përmendur në nënparagrafin “b”, të paragrafit 7, ai njoftim do të trajtohet si kërkesë për informacione shtesë sipas nënparagrafit “b”, të paragrafit 6.

10. Autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese do të vendosin mënyrën e zbatimit të dispozitave të kësaj pjese me marrëveshje të ndërsjellë (në përputhje me nenin e marrëveshjes përkatëse për tatimet e mbuluara në lidhje me procedurat për marrëveshje të ndërsjellë), duke përfshirë informacionin minimal të nevojshëm për secilin autoritet kompetent për të ndërmarrë shqyrtim thelbësor të çështjes. Një marrëveshje e tillë do të lidhet para datës në të cilën çështjet e pazgjidhura në një rast bëhen për herë të parë të pranueshme për t’u dorëzuar në arbitrazh dhe mund të ndryshohen herë pas here më vonë.

11. Për qëllime të zbatimit të këtij neni në marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara, një Palë mund të rezervojë të drejtën për të zëvendësuar periudhën dyvjeçare të përcaktuar në nënparagrafin “b”, të paragrafit 1, me një periudhë trevjeçare.

12. Një Palë mund të rezervojë të drejtën që rregullat e mëposhtme të zbatohen në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara, pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij neni:

a) çdo çështje e pazgjidhur që rezulton nga një procedurë e marrëveshjes së ndërsjellë, brenda fushës së procesit të arbitrazhit të parashikuar nga kjo Konventë, nuk do të paraqitet në arbitrazh, nëse një vendim mbi këtë çështje tashmë është dhënë nga një gjykatë ose gjykatë administrative e njërit prej juridiksioneve kontraktuese;

b) nëse në çfarëdo kohe pas një kërkesë për arbitrazh dhe para se paneli i arbitrazhit të ketë dorëzuar vendimin e tij tek autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese, një vendim në lidhje me çështjen është dhënë nga një gjykatë ose një gjykatë administrative e njërit prej juridiksioneve kontraktuese, procesi i arbitrazhit do të mbyllet.

Neni 20
Emërimi i arbitrave

1. Me përjashtim të rasteve kur autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese bien dakord reciprokisht për rregulla të ndryshme, paragrafët nga 2 deri 4 do të zbatohen për qëllimet e kësaj pjese.

2. Rregullat e mëposhtme do të rregullojnë emërimin e anëtarëve të një paneli arbitrazhi:

a) Paneli i arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë individualë me njohuri ose përvojë në çështjet tatimore në nivel ndërkombëtar.

b) Secili autoritet kompetent emëron një anëtar paneli brenda 60 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh sipas paragrafit 1, të nenit 19 ("Arbitrazhi i detyrueshëm"). Dy anëtarët e panelit të emëruar në këtë mënyrë, brenda 60 ditëve nga emërimi i tyre i fundit, emërojnë një anëtar të tretë që do të veprojë si Kryetar i Panelit të Arbitrazhit. Kryetari nuk duhet të jetë shtetas ose rezident i asnjërës prej juridiksioneve kontraktuese.

c) Secili anëtar i emëruar në panelin e arbitrazhit duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur nga autoritetet kompetente, administratat tatimore dhe ministritë e financave të juridiksioneve kontraktuese dhe të gjithë personat të prekur drejtpërdrejt nga çështja (si dhe këshilltarët e tyre) në kohën e pranimit të një emërimi, do të ruajnë paanshmërinë dhe pavarësinë gjatë gjithë procesit dhe për një periudhë të arsyeshme kohore do të shmangin çdo sjellje që mund të dëmtojë përshtypjen e paanshmërisë dhe pavarësisë së arbitrave në lidhje me procedurat.

3. Në rast se autoriteti kompetent i një juridiksioni kontraktues nuk arrin të emërojë një anëtar të panelit të arbitrazhit në mënyrën dhe brenda periudhave kohore të përcaktuara në paragrafin 2 ose siç janë pranuar nga autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese, do të emërohet një anëtar në emër të atij autoriteti kompetent nga zyrtari më i lartë i Qendrës për Politika dhe Administrim Tatimor të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, që nuk është shtetas i asnjë juridiksioni kontraktues.

4. Nëse dy anëtarët fillestarë të panelit të arbitrazhit nuk arrijnë të emërojnë Kryetarin në mënyrën dhe brenda periudhave kohore të përcaktuara në paragrafin 2 ose siç janë pranuar nga autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese, Kryetari do të emërohet nga zyrtari më i lartë i Qendrës për Politika dhe Administratën Tatimore të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, i cili nuk është shtetas i asnjë juridiksioni kontraktues.

Neni 21
Konfidencialiteti i procedurave të arbitrazhit

1. Vetëm për qëllimet e zbatimit të dispozitave të kësaj pjese dhe të dispozitave të marrëveshjes përkatëse për tatimet e mbuluara dhe të ligjeve vendase të juridiksioneve kontraktuese në lidhje me shkëmbimin e informacionit, konfidencialitetin dhe ndihmën administrative, anëtarët e panelit të arbitrazhit dhe një maksimum personeli prej tre vetash për anëtar (dhe arbitra të ardhshëm vetëm në masën që është e nevojshme për të verifikuar aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesat e arbitrazhit) do të konsiderohen si persona apo autoritete të cilëve mund t'u jepen informacionet. Informacioni i marrë nga paneli i arbitrazhit ose arbitrat e ardhshëm dhe informacioni që autoritetet kompetente marrin nga paneli i arbitrazhit do të konsiderohet si informacion që shkëmbehet sipas dispozitave të marrëveshjes për tatimet e mbuluara që lidhet me shkëmbimin e informacionit dhe ndihmën administrative.

2. Autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese do të sigurojnë që anëtarët e panelit të arbitrazhit dhe stafi i tyre të bien dakord me shkrim që përpara se të veprojnë në një procedurë arbitrazhi, të trajtojnë çdo informacion në lidhje me procedurën e arbitrazhit në përputhje me detyrimet e konfidencialitetit dhe mosdeklarimit të përshkruara në dispozitat e marrëveshjes për tatime e mbuluara në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe ndihmën administrative dhe në

përputhje me ligjet në fuqi të juridiksioneve kontraktuese.

Neni 22

Zgjidhja e një çështjeje para përfundimit të arbitrazhit

Për qëllimet e kësaj pjese dhe të dispozitave të marrëveshjes përkatëse për tatimet e mbuluara, që parashikojnë zgjidhjen e çështjeve nëpërmjet marrëveshjes së ndërsjellë, procedura e marrëveshjes së ndërsjellë, si dhe procedura me arbitrazh në lidhje me një çështje do të përfundojnë nëse, në çdo kohë pas dërgimit të kërkesës për arbitrazh dhe para se paneli i arbitrazhit të ketë dorëzuar vendimin e tij tek autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese:

a) autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese arrijnë një marrëveshje të ndërsjellë për zgjidhjen e çështjes; ose

b) personi i cili ka paraqitur çështjen, e tërheq kërkesën për arbitrazh ose kërkesën për një procedurë me marrëveshje së ndërsjellë.

Neni 23

Lloji i procesit të arbitrazhit

1. Me përjashtim të rasteve kur autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese bien dakord reciprokisht për rregulla të ndryshme, rregullat e mëposhtme do të zbatohen në lidhje me procedurën e arbitrazhit sipas kësaj pjese:

a) Pas paraqitjes së një çështjeje në arbitrazh, autoriteti kompetent i secilit juridiksionit kontraktues duhet t'i paraqesë panelit të arbitrazhit, sipas një date të përcaktuar me marrëveshje, një rezolutë të propozuar, e cila i adresohet të gjitha aspekteve të pazgjidhura të çështjes (duke marrë parasysh të gjitha marrëveshjet e mëparshme e arritura për atë çështje ndërmjet autoriteteve kompetente të juridiksioneve kontraktuese). Rezoluta e propozuar do të kufizohet në një dispozitë të shumave specifike monetare (për shembull, të të ardhurave ose shpenzimeve) ose, kur specifikohet, në shkallën maksimale të tatimit të vendosur sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara, për çdo rregullim ose aspekt të ngjashëm të çështjes. Në një rast në të cilin autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese nuk kanë arritur të lidhin një marrëveshje për një çështje në lidhje me kushtet për zbatimin e një dispozite të marrëveshjes përkatëse për tatimet e mbuluara (në vijim të referuara si: "pyetje parësore"), siç do të ishte nëse një individ është rezident ose nëse ekziston një seli e përhershme, autoritetet kompetente mund të paraqesin rezoluta alternative të propozuara në lidhje me çështjet për të cilat përcaktimi është i kushtëzuar nga zgjidhja e pyetjeve të tilla parësore.

b) Autoriteti kompetent i secilit juridiksion kontraktues mund të paraqesë gjithashtu një dokument mbështetës të pozicionit për shqyrtim nga ana e panelit të arbitrazhit. Secili autoritet kompetent që paraqet një rezolutë të propozuar ose një dokument mbështetës të pozicionit do t'i japë një kopje autoritetit tjetër kompetent deri në datën e fundit të përcaktuar për dërgimin e zgjidhjes së propozuar dhe dokumentit mbështetës të pozicionit. Çdo autoritet kompetent mund të paraqesë gjithashtu në panelin e arbitrazhit, me një datë të caktuar me marrëveshje, një parashtrim të përgjigjes në lidhje me rezolutën e propozuar dhe dokumentin mbështetës të pozicionit të paraqitur nga autoriteti tjetër kompetent. Një kopje e çdo përgjigjeje të dërguar do t'i jepet autoritetit tjetër kompetent deri në datën e fundit për dërgimin e përgjigjes.

c) Paneli i arbitrazhit do të zgjedhë si vendim të tij një nga rezolutat e propozuara për rastin e paraqitur nga autoritetet kompetente në lidhje me secilën çështje dhe çdo pyetje parësore dhe nuk do të përfshijë arsyetim apo ndonjë shpjegim tjetër të vendimit. Vendimi i arbitrazhit do të miratohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të panelit. Paneli i arbitrazhit duhet të dorëzojë me shkrim vendimin e tij tek autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese. Vendimi i arbitrazhit nuk ka vlerë paraprake.

2. Për qëllimin e zbatimit të këtij neni në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara, një Palë mund të rezervojë të drejtën që paragrafi 1 të mos zbatohet në marrëveshjet e saj tatimore të mbuluara. Në një rast të tillë, me përjashtim të masave në të cilat autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese bien dakord reciprokisht për rregulla të ndryshme, rregullat e mëposhtme do të zbatohen në lidhje me procedurën e arbitrazhit:

a) Pasi një çështje paraqitet për arbitrazh, autoriteti kompetent i secilit juridiksion kontraktues do të japë çdo informacion që mund të jetë i nevojshëm për vendimin e arbitrazhit për të gjithë anëtarët e panelit pa vonesa të panevojshme. Me përjashtim të rasteve kur autoritetet kompetente të juridiksionit kontraktues bien dakord ndryshe, çdo informacion që nuk ishte i disponueshëm për të dyja autoritetet kompetente para marrjes së kërkesës për arbitrazh nga të dyja palët, nuk do të merret parasysh për qëllimet e vendimit.

b) Paneli i arbitrazhit do të vendosë çështjet e paraqitura në arbitrazh në përputhje me dispozitat e zbatueshme të marrëveshjes për tatimet e mbuluara dhe, sipas këtyre dispozitave, të atyre të ligjeve të vendit të juridiksioneve kontraktuese. Anëtarët e panelit do të marrin gjithashtu në konsideratë çdo burim tjetër që autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese mund të identifikojnë shprehimisht me marrëveshje të ndërsjellë.

c) Vendimi i arbitrazhit do t'i dorëzohet me shkrim autoriteteve kompetente të juridiksioneve kontraktuese dhe do të tregojë burimet e ligjit ku është bazuar dhe arsyetimin që çoi në rezultatin e tij. Vendimi i arbitrazhit miratohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të panelit. Vendimi i arbitrazhit nuk ka vlerë paraprake.

3. Një Palë që nuk ka bërë rezervën e përshkruar në paragrafin 2 mund të rezervojë të drejtën që paragrafët paraardhës të këtij neni të mos zbatohen në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara me Palët që kanë bërë një rezervë të tillë. Në këtë rast, autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese të çdo marrëveshjeje të tillë për tatimet e mbuluara do të përpiqen të arrijnë marrëveshje për llojin e procesit të arbitrazhit që do të zbatohet në lidhje me atë marrëveshje për tatimet e mbuluara. Derisa të arrihet një marrëveshje e tillë, neni 19 ("Arbitrazhi i detyrueshëm") nuk do të zbatohet në lidhje me një marrëveshje të tillë për tatimet e mbuluara.

4. Një Palë mund të zgjedhë gjithashtu të zbatojë paragrafin 5 në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara dhe do të njoftojë Depozituesin në përputhje me rrethanat. Paragrafi 5 do të zbatohet në lidhje me dy juridiksionet kontraktuese për sa i takon një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kur njëra prej juridiksioneve kontraktuese ka bërë një njoftim të tillë.

5. Para fillimit të procedurës së arbitrazhit, autoritetet kompetente të juridiksionit kontraktues në një marrëveshje për tatimet e mbuluara do të garantojnë që secili person që ka paraqitur çështjen dhe këshilltarët e tyre bien dakord me shkrim që të mos i zbulojnë ndonjë personi tjetër asnjë informacion të marrë gjatë rrjedhës së procedurave të arbitrazhit nga autoriteti kompetent ose nga paneli i arbitrazhit. Procedura e marrëveshjes së përbashkët (marrëveshjes me mirëkuptim) sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara, si dhe procedura e arbitrazhit sipas kësaj pjese, në lidhje me çështjen do të përfundojnë nëse, në çdo kohë pasi është bërë një kërkesë për arbitrazh dhe para se paneli i arbitrazhit të ketë marrë vendimin e tij autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese, një person që ka paraqitur çështjen ose një nga këshilltarët e atij personi shkel këtë marrëveshje nga pikëpamja materiale.

6. Pavarësisht nga paragrafi 4, një Palë që nuk zgjedh të zbatojë paragrafin 5, mund të rezervojë të drejtën që të mos zbatojë paragrafin 5 në lidhje me një ose më shumë marrëveshje të identifikuar për tatimet e mbuluara ose në lidhje me të gjitha marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

7. Një Palë që zgjedh të zbatojë paragrafin 5 mund të rezervojë të drejtën që kjo pjesë të mos zbatohet në lidhje me të gjitha marrëveshjet për tatimet e mbuluara për të cilat juridiksioni tjetër kontraktues bën një rezervë sipas paragrafit 6.

Neni 24

Marrëveshja për një rezolutë të ndryshme

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj pjese në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara, një Palë mund të zgjedhë të zbatojë paragrafin 2 dhe do të njoftojë Depozituesin në përputhje me rrethanat. Paragrafi 2 do të zbatohet për dy juridiksionet kontraktuese në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm kur të dy juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim të tillë.

2. Pavarësisht nga paragrafi 4 i nenit 19 (“Arbitrazhi i detyrueshëm”), vendimi i arbitrazhit sipas kësaj pjese nuk do të jetë i detyrueshëm për juridiksionet kontraktuese në një marrëveshje për tatimet e mbuluara dhe nuk do të zbatohet, nëse autoritetet kompetente të juridiksioneve kontraktuese bien dakord për një rezolutë të ndryshme të të gjitha aspekteve të pazgjidhura brenda tre muajve kalendarikë pasi u është dorëzuar vendimi i arbitrazhit.

3. Një Palë që zgjedh të zbatojë paragrafin 2, mund të rezervojë të drejtën që të zbatojë paragrafin 2 vetëm në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara për të cilat zbatohet paragrafi 2 i nenit 23 (“Lloji i procedurës së arbitrazhit”).

Neni 25

Shpenzimet e procedurave të arbitrazhit

Në kuadrin e një procedure arbitrazhi sipas kësaj pjese, tarifat dhe shpenzimet e anëtarëve të panelit të arbitrazhit, si dhe çdo shpenzim i kryer në lidhje me procedurat e arbitrazhit nga juridiksionet kontraktuese, do të mbulohen nga juridiksionet kontraktuese në një mënyrë që duhet të përcaktohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet autoriteteve kompetente të juridiksioneve kontraktuese. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, çdo juridiksion kontraktues do të mbulojë shpenzimet e veta dhe ato të anëtarëve të tij të emëruar të panelit. Kostoja e kryesuesit të panelit të arbitrazhit dhe shpenzimet e tjera që lidhen me zhvillimin e procedurave të arbitrazhit do të mbulohen nga juridiksionet kontraktuese në pjesë të barabarta.

Neni 26

Pajtueshmëria

1. Sipas nenit 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”), dispozitat e kësaj pjese do të zbatohen në vend të ose në mungesë të dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara që parashikon arbitrazhin e aspekteve të pazgjidhura që rrjedhin nga një procedurë e marrëveshjes së përbashkët. Secila Palë që zgjedh të zbatojë këtë pjesë do të njoftojë Depozituesin, nëse secila prej marrëveshjeve të saj për tatimet e mbuluara, përveç atyre që janë në kuadër të një rezerve sipas paragrafit 4, përmban një dispozitë të tillë dhe nëse po, numrin e nenit dhe paragrafit të secilës dispozitë të tillë. Kur dy juridiksionet kontraktuese kanë bërë një njoftim në lidhje me një dispozitë të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, kjo dispozitë do të zëvendësohet me dispozitat e kësaj pjese ndërmjet atyre juridiksioneve kontraktuese.

2. Çdo çështje e pazgjidhur që rrjedh nga një procedurë e marrëveshjes me mirëkuptim, e përfshirë në qëllimin e procesit të arbitrazhit të parashikuar në këtë pjesë, nuk duhet të paraqitet në arbitrazh nëse çështja përfshihet në objektin e një çështjeje në lidhje me të cilën një panel arbitrazhi apo një organ i ngjashëm është krijuar më parë në përputhje me një konventë dypalëshe ose shumëpalëshe që parashikon arbitrazhin e detyrueshëm për çështjet e pazgjidhura që rrjedhin nga një procedurë me mirëkuptim.

3. Sipas paragrafit 1, asgjë në këtë pjesë nuk do të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve më të gjera në lidhje me arbitrazhin e çështjeve të pazgjidhura që rrjedhin në kontekstin e procedurës me mirëkuptim që rrjedh nga konventa të tjera, të cilat juridiksionet kontraktuese janë ose do të bëhen palë.

4. Një Palë mund të rezervojë të drejtën të mos e zbatojë këtë pjesë në lidhje me një ose më shumë marrëveshje të identifikuara për tatimet e mbuluara (ose të gjitha marrëveshjet për tatimet e mbuluara) që tashmë parashikojnë arbitrazh të detyrueshëm për çështjet e pazgjidhura që rrjedhin nga një procedurë me mirëkuptim.

PJESA VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Nënshkrimi dhe ratifikimi, pranimi ose miratimi

1. Që nga data 31 dhjetor 2016, kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga:
 - a) të gjitha shtetet;
 - b) Guernsey (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut); Isle of Man (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut); Jersey (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut);
 - c) çdo juridiksion tjetër i autorizuar për t'u bërë Palë me anë të një vendimi me konsensus të Palëve dhe nënshkruesve.
2. Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit.

Neni 28

Rezervat

1. Në bazë të paragrafit 2, nuk mund të bëhen rezerva për këtë Konventë, përveç atyre të lejuara shprehimisht nga:
 - a) paragrafi 5 i nenit 3 ("Subjektet transparente");
 - b) paragrafi 3 i nenit 4 ("Subjektet me rezidencë të dyfishtë");
 - c) paragrafët 8 dhe 9 të nenit 5 ("Zbatimi i metodave për eliminimin e tatimit të dyfishtë");
 - d) paragrafi 4 i nenit 6 ("Qëllimi i një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara");
 - e) paragrafët 15 dhe 16 të nenit 7 ("Parandalimi i abuzimit me marrëveshjen");
 - f) paragrafi 3 i nenit 8 ("Transaksionet e transferimit të dividendëve");
 - g) paragrafi 6 i nenit 9 ("Fitimet kapitale nga tjetërsimi i aksioneve ose interesat e subjekteve, vlera e të cilave përfaqësohet kryesisht nga pasuritë e paluajtshme");
 - h) paragrafi 5 i nenit 10 ("Rregulla kundër abuzimit për institucionet e përhershme të vendosura në juridiksione të treta");
 - i) paragrafi 3 i nenit 11 ("Zbatimi i marrëveshjeve tatimore për kufizimin e të drejtës së palës për tatimin e rezidentëve të saj");
 - j) paragrafi 4 i nenit 12 ("Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme nëpërmjet marrëveshjeve të komisionerëve dhe strategjive të ngjashme");
 - k) paragrafi 6 i nenit 13 ("Shmangia artificiale e Statutit të Përhershëm të Formimit nëpërmjet Përrjashtimeve të Veprimtarisë Specifike");
 - l) paragrafi 3 i nenit 14 ("Ndarja e kontratave");
 - m) paragrafi 2 i nenit 15 ("Përkufizimi i një personi të lidhur ngushtë me një ndërmarrje");
 - n) paragrafi 5 i nenit 16 ("Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë");
 - o) paragrafi 3 i nenit 17 ("Rregullimet korresponduese");
 - p) paragrafët 11 dhe 12, të nenit 19 ("Arbitrazhi i detyrueshëm");
 - q) paragrafët 2, 3, 6 dhe 7, të nenit 23 ("Lloji i procesit të arbitrazhit");
 - r) paragrafi 3 i nenit 24 ("Marrëveshja për zgjidhje të ndryshme");
 - s) paragrafi 4 i nenit 26 ("Pajtueshmëria");
 - t) paragrafët 6 dhe 7 të nenit 35 ("Hyrja në fuqi"); dhe
 - u) paragrafi 2 i nenit 36 ("Fillimi i efektit të pjesës VI").

2. a) Pavarësisht nga paragrafi 1, një Palë që zgjedh sipas nenit 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”) të zbatojë pjesën VI (“Arbitrazhi”) mund të formulojë një ose më shumë rezerva në lidhje me qëllimin e rasteve që do të jenë të pranueshme për arbitrazh sipas dispozitave të pjesës VI (“Arbitrazhi”). Për një Palë që zgjedh sipas nenit 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”) të zbatojë pjesën VI (“Arbitrazhi”) pasi të jetë bërë Palë në këtë Konventë, rezervat në përputhje me këtë nënparagraf do të bëhen në të njëjtën kohë që Pala njofton Depozituesin sipas nenit 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”).

b) Rezervat e bëra sipas nënparagrafit “a” janë objekt pranimi. Një rezervë e bërë sipas nënparagrafit “a” do të konsiderohet të jetë pranuar nga një Palë nëse ajo nuk e ka njoftuar Depozituesin se e kundërshton rezervën deri në fund të një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh kalendarikë duke filluar nga data e njoftimit të rezervës nga Depozituesi ose nga data në të cilën ai depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi ose miratimit, cildo që të jetë më vonë. Për një Palë që zgjedh sipas nenit 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”) të zbatojë pjesën VI (“Arbitrazhi”) pasi të jetë bërë Palë në këtë Konventë, kundërshtimet ndaj rezervave të mëparshme të bëra nga Palët e tjera sipas nënparagrafit “a” mund të bëhen në kohën e njoftimit të Palës së Parë për Depozituesin në përputhje me nenin 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”). Kur një Palë ngre kundërshtim ndaj një rezerve të bërë sipas nënparagrafit “a”, e gjithë pjesa VI (“Arbitrazhi”) nuk do të zbatohet ndërmjet Palës që bën kundërshtimin dhe Palës që shpreh rezerva.

3. Nëse nuk parashikohet ndryshe shprehimisht në dispozitat përkatëse të kësaj Konvente, një rezervë e përgatitur në përputhje me paragrafin 1 ose 2:

a) do të ndryshojë për Palën që shpreh rezerva në marrëdhëniet e saj me një Palë tjetër, dispozitat e kësaj Konvente, të cilave u referohet rezerva në masën e parashikuar nga rezerva përkatëse; dhe

b) do të ndryshojë këto dispozita në të njëjtën masë për Palën tjetër në marrëdhëniet e saj me Palën që shpreh rezervë.

4. Rezervat që zbatohen në marrëveshjet për tatimet e mbuluara të lidhura nga/ose në emër të një juridiksioni ose territori për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjëse një Palë, nëse juridiksioni ose territori në fjalë nuk është Palë në Konventë në përputhje me nënparagrafin “b” ose “c”, të paragrafit 1, të nenit 27 (“Nënshkrimi dhe ratifikimi, pranimi ose miratimi”) do të bëhen nga Pala përgjegjëse dhe mund të jenë të ndryshme nga rezervat e bëra nga kjo Palë për marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

5. Rezervat duhet të bëhen në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2, 6 dhe 9 të këtij neni dhe paragrafit 5, të nenit 29 (“Njoftimet”). Megjithatë, për një Palë që zgjedh sipas nenit 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”) të zbatojë pjesën VI (“Arbitrazhi”) pasi të jetë bërë Palë në këtë Konventë, rezervat e përshkruara në nënparagrafët “p”, “q”, “r” dhe “s” të paragrafit 1 të këtij neni do të përgatiten në të njëjtën kohë me njoftimin e kësaj Pale drejtuar Depozituesit në pajtim me nenin 18 (“Opsioni për të zbatuar pjesën VI”).

6. Nëse rezervat përgatiten në kohën e nënshkrimit, ato do të konfirmohen pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit, me përjashtim të rastit në të cilin dokumenti që përmban rezervat specifikon shprehimisht faktin që instrumenti do të konsiderohet përfundimtar, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2, 5 dhe 9, të këtij neni, dhe paragrafin 5, të nenit 29 (“Njoftimet”).

7. Nëse rezervat nuk janë përgatitur në kohën e nënshkrimit, një listë e përkohshme e rezervave të pritshme do t’i jepet Depozituesit në atë kohë.

8. Për rezervat e përgatitura në përputhje me secilën nga dispozitat e mëposhtme, një listë marrëveshjeve të njoftuara sipas klauzolës “ii”, të nënparagrafit “a”, të paragrafit 1, të nenit 2 (“Interpretimi i termave”) që përfshihet në objektin e zbatimit të rezervës, siç përcaktohet në dispozitën përkatëse (dhe në rastin e një rezerve, sipas cilësdo prej dispozitave të mëposhtme përveç atyre të renditura në nënparagrafët “c”, “d” dhe “n”, numri i nenit dhe i paragrafit të

secilës dispozitë përkatëse), duhet të sigurohen kur bëhen këto rezerva:

- a) nënparagrafët “b”, “c”, “d”, “e” dhe “g”, të paragrafit 5, të nenit 3 (“Subjektet transparente”);
- b) nënparagrafët “b”, “c” dhe “d”, të paragrafit 3, të nenit 4 (“Subjektet me rezidencë të dyfishtë”);
- c) paragrafët 8 dhe 9, të nenit 5 (“Zbatimi i metodave për eliminimin e tatimit të dyfishtë”);
- d) paragrafi 4, i nenit 6 (“Qëllimi i një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara”);
- e) nënparagrafët “b” dhe “c”, të paragrafit 15, të nenit 7 (“Parandalimi i abuzimit me marrëveshjen”);
- f) klauzolat “i”, “ii” dhe “iii”, të nënparagrafit “b”, të paragrafit 3, të nenit 8 (“Transaksionet e transferimit të dividendëve”);
- g) nënparagrafët “d”, “e” dhe “f”, të paragrafit 6, të nenit 9 (“Fitimet kapitale nga tjetërsimi i aksioneve ose interesat e subjekteve, vlera e të cilave përfaqësohet kryesisht nga pasuritë e paluajtshme”);
- h) nënparagrafët “b” dhe “c”, të paragrafit 5, të nenit 10 (“Rregulla kundër abuzimit për institucionet e përhershme të vendosura në juridiksione të treta”);
- i) nënparagrafi “b”, i paragrafit 3, të nenit 11 (“Zbatimi i marrëveshjeve tatimore për kufizimin e të drejtës së palës për tatimin e rezidentëve të saj”);
- j) nënparagrafi “b”, i paragrafit 6, të nenit 13 (“Shmangia artificiale e Statutit të Përhershëm të Formimit nëpërmjet Përrjashtimeve të Veprimtarisë Specifike”);
- k) nënparagrafi “b”, i paragrafit 3, të nenit 14 (“Ndarja e kontratave”);
- l) nënparagrafi “b”, i paragrafit 5, të nenit 16 (“Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë”);
- m) nënparagrafi “a”, i paragrafit 3, të nenit 17 (“Rregullimet korresponduese”);
- n) paragrafi 6, i nenit 23 (“Lloji i procesit të arbitrazhit”); dhe
- o) paragrafi 4, i nenit 26 (“Pajtueshmëria”).

Rezervat e përshkruara në nënparagrafët nga “a” deri në “o” më sipër nuk do të zbatohen për asnjë marrëveshje për tatimet e mbuluara që nuk është përfshirë në listën e përshkruar në këtë paragraf.

9. Çdo Palë që ka bërë një rezervë në përputhje me paragrafin 1 ose 2, në çdo kohë mund ta tërheqë ose zëvendësojë atë me një rezervë më të kufizuar, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Depozituesit. Pala e tillë do të bëjë çdo njoftim shtesë në përputhje me paragrafin 6, të nenit 29 (“Njoftimet”), të cilat mund të kërkojnë si rezultat i tërheqjes ose zëvendësimit të rezervës. Në bazë të paragrafit 7, të nenit 35 (“Hyrja në fuqi”), tërheqja ose zëvendësimi do të hyjë në fuqi:

a) në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara vetëm me shtetet ose juridiksionet që janë palë në Konventë, kur njoftimi për tërheqjen ose zëvendësimin e rezervës është marrë nga Depozituesi:

i) për rezervat në lidhje me dispozitat që lidhen me tatimet e mbajtura në burim, kur rasti që çon në tatime të tilla ndodh në ose pas datës 1 janar të vitit pasardhës pas skadimit të një periudhe gjashtë mujore kalendarike që fillon nga data e komunikimit, nga ana e Depozitarit, të njoftimit për tërheqjen ose zëvendësimin e rezervës; dhe

ii) për rezervat në lidhje me të gjitha dispozitat e tjera, për tatimet e vendosura në lidhje me periudhat e tatueshme që fillojnë në ose pas datës 1 janar të vitit pasardhës pas skadimit të një periudhe gjashtë mujore kalendarike që fillon nga data e komunikimit, nga ana e Depozituesit, të njoftimit për tërheqjen ose zëvendësimin e rezervës; dhe

b) në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara për të cilën një ose më shumë juridiksione kontraktuese bëhen Palë në këtë Konventë pas datës së marrjes nga ana e Depozituesit të njoftimit për tërheqjen ose zëvendësimin: në datën e fundit në të cilën Konventa hyn në fuqi për ato juridiksione kontraktuese.

Neni 29 Njoftimet

1. Në përputhje me paragrafët 5 dhe 6, të këtij neni, dhe paragrafin 7, të nenit 35 (“Hyrja në fuqi”), njoftimet në zbatim të dispozitave të mëposhtme do të bëhen në kohën e nënshkrimit ose kur depozitohet instrumenti i ratifikimit, pranimi ose miratimit:

- a) klauzola “ii”, e nënparagrafit “a”, të paragrafit 1, të nenit 2 (“Interpretimi i termave”);
- b) paragrafi 6 i nenit 3 (“Subjektet transparente”);
- c) paragrafi 4 i nenit 4 (“Subjektet me rezidencë të dyfishtë”);
- d) paragrafi 10 i nenit 5 (“Zbatimi i metodave për eliminimin e tatimit të dyfishtë”);
- e) paragrafët 5 dhe 6, të nenit 6 (“Qëllimi i një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara”);
- f) paragrafi 17 i nenit 7 (“Parandalimi i abuzimit me marrëveshjen”);
- g) paragrafi 4 i nenit 8 (“Transaksionet e transferimit të dividendëve”);
- h) paragrafët 7 dhe 8, të nenit 9 (“Fitimet kapitale nga tjetërsimi i aksioneve ose interesat e subjekteve, vlera e të cilave përfaqësohet kryesisht nga pasuritë e paluajtshme”);
- i) paragrafi 6 i nenit 10 (“Rregulla kundër abuzimit për institucionet e përhershme të vendosura në juridiksione të treta”);
- j) paragrafi 4 i nenit 11 (“Zbatimi i marrëveshjeve tatimore për kufizimin e të drejtës së palës për tatimin e rezidentëve të saj”);
- k) paragrafët 5 dhe 6, të nenit 12 (“Shmangia artificiale e statusit të selisë së përhershme nëpërmjet marrëveshjeve të komisionerëve dhe strategjive të ngjashme”);
- l) paragrafët 7 dhe 8, të nenit 13 (“Shmangia artificiale e Statutit të Përhershëm të Formimit nëpërmjet Përrjashtimeve të Veprimtarisë Specifike”);
- m) paragrafi 4 i nenit 14 (“Ndarja e kontratave”);
- n) paragrafi 6 i nenit 16 (“Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë”);
- o) paragrafi 4 i nenit 17 (“Rregullimet korresponduese”);
- p) neni 18 (“Zgjedhja për të zbatuar pjesën VI”);
- q) paragrafi 4 i nenit 23 (“Lloji i procesit të arbitrazhit”);
- r) paragrafi 1 i nenit 24 (“Marrëveshja për zgjidhje të ndryshme”);
- s) paragrafi 1 i nenit 26 (“Pajtueshmëria”); dhe
- t) paragrafët 1, 2, 3, 5 dhe 7 të nenit 35 (“Hyrja në fuqi”).

2. Njoftimet në lidhje me marrëveshjet për tatimet e mbuluara të nënshkruara nga/ose në emër të një juridiksioni ose territori për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit një Palë është përgjegjëse, kur ky juridiksion ose territor nuk është Palë e Konventës në përputhje me nënparagrafin “b” ose “c”, të paragrafit 1, të nenit 27 (“Nënshkrimi dhe ratifikimi, pranimi ose miratimi”), do të bëhen nga Pala përgjegjëse dhe mund të jenë të ndryshme nga njoftimet e bëra nga kjo Palë për marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

3. Nëse njoftimet bëhen në kohën e nënshkrimit, ato do të konfirmohen pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit, me përjashtim të rasteve kur dokumenti që përmban njoftimet, përcakton shprehimisht se ai duhet të konsiderohet përfundimtar, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 5 dhe 6 të këtij neni dhe paragrafit 7 të nenit 35 (“Hyrja në fuqi”).

4. Nëse njoftimet nuk bëhen në kohën e nënshkrimit, një listë e përkohshme e njoftimeve të pritshme do të ofrohet në atë kohë.

5. Një Palë mund të zgjasë në çdo kohë listën e marrëveshjeve të njoftuara sipas klauzolës “ii”, të nënparagrafit “a”, të paragrafit 1, të nenit 2 (“Interpretimi i termave”) me anë të një njoftimi drejtuar Depozituesit. Pala do të përcaktojë në këtë njoftim nëse marrëveshja përfshihet në kuadrin e ndonjë prej rezervave të përgatitura nga Pala, të renditura në paragrafin 8, të nenit 28 (“Rezervat”). Pala gjithashtu mund të bëjë një rezervë të re të përshkruar në paragrafin 8, të nenit 28 (“Rezervat”), nëse marrëveshja shtesë do të ishte e para që do të përfshihej në objektin e një rezerve të tillë. Pala gjithashtu do të specifikojë çdo njoftim shtesë që mund të jetë i nevojshëm

sipas nënparagrafëve nga “b” deri në “s”, të paragrafit 1, për të pasqyruar përfshirjen e marrëveshjeve shtesë. Gjithashtu, nëse shtyrja rezulton për herë të parë në përfshirjen e një marrëveshjeje tatimore të lidhur nga/ose në emër të një juridiksioni ose territori për marrëdhëniet ndërkombëtare të së cilit një Palë është përgjegjëse, Pala do të specifikojë çdo rezervë (sipas paragrafit 4 të neni 28 (“Rezervat”)) ose njoftime (sipas paragrafit 2 të këtij neni) të zbatueshme për marrëveshjet për tatimet e mbuluara të lidhura nga/ose në emër të atij juridiksioni ose territori. Në datën në të cilën marrëveshja/et e shtuar/a e/të njoftuar/a sipas klauzolës “ii”, të nënparagrafit “a”, të paragrafit 1, të nenit 2 (“Interpretimi i termave”) bëhet marrëveshje për tatimet e mbuluara, dispozitat e nenit 35 (“Hyrja në fuqi”) do të rregullojnë datën kur ndryshimet në marrëveshjen e për tatimet e mbuluara do të kenë efekt.

6. Një Palë mund të bëjë njoftime shtesë në përputhje me nënparagrafët “b” deri “s”, të paragrafit 1, me anë të një njoftimi drejtuar Depozituesin. Këto njoftime do të hyjnë në fuqi:

a) në lidhje me marrëveshjet për tatimet e mbuluara vetëm me shtetet ose juridiksionet që janë palë në Konventë kur njoftimi shtesë është marrë nga Depozituesi:

i. për njoftimet në lidhje me dispozitat që i referohen tatimeve të mbajtura në burim, kur rasti që shkakton tatime të tilla ndodh në ose pas datës 1 janar të vitit pasardhës pas skadimit të një periudhe gjashtë mujore kalendarike, duke filluar nga data e komunikimit të njoftimit shtesë nga ana e Depozituesit; dhe

ii. për njoftimet në lidhje me të gjitha dispozitat e tjera, për tatimet e vendosura në lidhje me periudhat tatimore që fillojnë në ose pas datës 1 janar të vitit pasardhës pas skadimit të një periudhe gjashtë mujore kalendarike, duke filluar nga data e komunikimit të njoftimit shtesë nga ana e Depozituesit; dhe

b) në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara për të cilën një ose më shumë juridiksione kontraktuese bëhen Palë në këtë Konventë pas datës së marrjes së njoftimit shtesë nga Depozituesi: e fundit nga datat në të cilat Konventa hyn në fuqi për ato juridiksione kontraktuese.

Neni 30

Ndryshimet e mëvonshme të marrëveshjeve për tatimet e mbuluara

Dispozitat në këtë Konventë nuk cenojnë ndryshimet e mëvonshme të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, të cilat mund të pranohen ndërmjet juridiksioneve kontraktuese të marrëveshjes për tatimet e mbuluara.

Neni 31

Konsultimi i Palëve

1. Palët mund të kërkojnë organizimin e një konsultimi të Palëve, me qëllimin e marrjes së çdo lloj vendimi ose ushtrimi të funksioneve që mund të kërkojnë ose të jenë të përshtatshme sipas dispozitave të kësaj Konvente.

2. Konsultimi i Palëve do të organizohet nga Depozituesi.

3. Çdo Palë mund të kërkojë organizimin e një konsultimi të Palëve, duke komunikuar një kërkesë te Depozituesi. Depozituesi duhet të informojë të gjitha Palët për çdo kërkesë. Pas kësaj, Depozituesi do të thërrasë një Konsultim të Palëve, me kusht që kërkesa të mbështetet nga një e treta e Palëve brenda gjashtë muajve kalendarikë nga njoftimi i kërkesës nga ana e Depozituesit.

Neni 32

Interpretimi dhe zbatimi

1. Çdo çështje që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të një marrëveshjeje për tatimet e mbuluara, siç është ndryshuar nga kjo Konventë, do të përcaktohet

në përputhje me dispozitën/at e marrëveshjes për tatimet e mbuluara në lidhje me zgjidhjen me marrëveshje të ndërsjellë/me mirëkuptim të çështjeve të interpretimit ose zbatimit të marrëveshjes për tatimet e mbuluara (siç ato dispozita mund të ndryshohen nga kjo Konventë).

2. Çdo çështje që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente mund të diskutohet në kuadrin e një konsultimi të Palëve, të organizuar në përputhje me paragrafin 3, të nenit 31 (“Konsultimi i Palëve”).

Neni 33 Ndryshimi

1. Çdo Palë mund të propozojë një ndryshim në këtë Konventë, duke paraqitur amendimin e propozuar te Depozituesi.

2. Një konsultim Palësh mund të organizohet për të shqyrtuar ndryshimin e propozuar në përputhje me paragrafin 3, të nenit 31 (“Konsultimi i Palëve”).

Neni 34 Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vijon pas përfundimit të një periudhe tre mujore kalendarike, e cila fillon nga data e depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

2. Për çdo nënshkrues që ratifikon, pranon ose miraton këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vijon pas përfundimit të një periudhe tre mujore kalendarike, e cila fillon nga data e depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit ose miratimit nga ai nënshkrues.

Neni 35 Fillimi i efekteve

1. Dispozitat e kësaj Konvente do të kenë efekt në çdo juridiksion kontraktues në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim për shumat e paguara ose të kredituara për jorezidentët, ku ngjarja që çon në tatime të tilla ndodh në ose pas ditës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik që fillon në ose pas datës së fundit në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për secilin nga juridiksionet kontraktuese në marrëveshjen për tatimet e mbuluara; dhe

b) në lidhje me të gjitha tatimet e tjera të vendosura nga ky juridiksion kontraktues, për tatimet e vendosura në lidhje me periudhat tatimore që fillojnë në ose pas skadimit të një periudhe gjashtë mujore kalendarike (ose një periudhe më të shkurtër, nëse të gjitha juridiksionet kontraktuese njoftojnë Depozitarin se ata synojnë të zbatojnë një periudhë të tillë më të shkurtër) nga data e fundit në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për secilin prej juridiksioneve kontraktuese në marrëveshjen për tatimet e mbuluara.

2. Vetëm për qëllimin e zbatimit të nënparagrafit “a”, të paragrafit 1, dhe nënparagrafit “a”, të paragrafit 5 nga ana e saj, një Palë mund të zgjedhë të zëvendësojë “vitin kalendarik” me “periudhën e tatueshme” dhe do të njoftojë Depozituesin në përputhje me rrethanat.

3. Vetëm për qëllimin e zbatimit të nënparagrafit “b”, të paragrafit 1, dhe nënparagrafit “b” të paragrafit 5 nga ana e saj, një Palë mund të zgjedhë të zëvendësojë referencën për “periudhat e tatueshme që fillojnë në ose pas përfundimit të një periudhe” me një referencë për “periudhat tatimore që fillojnë më ose pas datës 1 janar të vitit të ardhshëm, duke filluar nga/ose pas përfundimit të një periudhe” dhe do të njoftojë Depozituesin në përputhje me rrethanat.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, neni 16 (“Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë”) do të ketë efekt në lidhje me një marrëveshje për tatimet e mbuluara për një rast të

paraqitur pranë autoritetit kompetent të një juridiksioni kontraktues në ose pas datës së fundit në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për secilin prej juridiksioneve kontraktuese në marrëveshjen për tatimet e mbuluara, me përjashtim të rasteve që nuk ishin të pranueshme për t'u paraqitur në atë datë sipas marrëveshjes për tatimet e mbuluara përpara ndryshimit të saj nga Konventa, pa marrë parasysh periudhën e tatueshme me të cilën lidhet rasti.

5. Për një marrëveshje të re për tatimet e mbuluara që rezulton nga një shtyrje në përputhje me paragrafin 5, të nenit 29 ("Njoftimet") të listës së marrëveshjeve të njoftuara sipas klauzolës "ii", të nënparagrafit "a", të paragrafit 1, të nenit 2 ("Interpretimi i termave"), dispozitat e kësaj Konvente do të kenë efekt në secilin juridiksion kontraktues:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim për shumat e paguara ose të kredituara për jorezidentët, kur rasti që çon në tatime të tilla ndodh në ose pas datës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik që fillon në ose pas 30 ditësh pas datës së komunikimit nga Depozituesi të njoftimit për zgjatjen e listës së marrëveshjeve; dhe

b) në lidhje me të gjitha tatimet e tjera të vendosura nga ai juridiksion kontraktues, për tatimet e vendosura në lidhje me periudhat tatimore që fillojnë në ose pas përfundimit të një periudhe prej nëntë muajsh kalendarike (ose një periudhe më të shkurtër, nëse të gjitha juridiksionet kontraktuese njoftojnë Depozituesin se ata synojnë të zbatojnë një periudhë të tillë më të shkurtër) nga data e komunikimit nga Depozituesi të njoftimit të zgjatjes së listës së marrëveshjeve.

6. Një Palë mund të rezervojë të drejtën të mos zbatojë paragrafin 4 në lidhje me marrëveshjet e saj për tatimet e mbuluara.

7. a) Një Palë mund të rezervojë të drejtën për të zëvendësuar:

i. referencat në paragrafët 1 dhe 4 për "datën e fundit në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për secilin prej juridiksioneve kontraktuese në marrëveshjen për tatimet e mbuluara"; dhe

ii. referencat në paragrafin 5 për "datën e komunikimit nga Depozituesi të njoftimit të zgjatjes së listës së marrëveshjeve";

me referencat për "30 ditë pas datës së marrjes nga Depozituesi të njoftimit të fundit nga çdo juridiksion kontraktues që bën rezervën e përshkruar në paragrafin 7 të nenit 35 ("Fillimi i efekteve") se ka përfunduar procedurat e saj të brendshme për fillimin e efekteve të dispozitave të kësaj Konvente në lidhje me atë marrëveshje specifike për tatimet e mbuluara";

iii. referencat në nënparagrafin a) të paragrafit 9 të nenit 28 (Rezervat) për "datën e komunikimit nga Depozituesi të njoftimit të tërheqjes ose zëvendësimit të rezervës"; dhe

iv. referencën në nënparagrafin "b", të paragrafit 9, të nenit 28 ("Rezervat") për "datën e fundit në të cilën Konventa hyn në fuqi për ato juridiksione kontraktuese";

referencat për "30 ditë pas datës së marrjes nga Depozituesi të njoftimit të fundit nga çdo juridiksion kontraktues që bën rezervën e përshkruar në paragrafin 7, të nenit 35 ("Fillimi i efekteve") në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme për fillimin e efekteve të tërheqjes ose zëvendësimit të rezervës në lidhje me atë marrëveshje specifike për tatimet e mbuluara";

v. referencat në nënparagrafin "a", të paragrafit 6, të nenit 29 ("Njoftimet") për "datën e komunikimit nga Depozituesi të njoftimit shtesë"; dhe

vi. referencën në nënparagrafin "b", të paragrafit 6, të nenit 29 ("Njoftimet") për "datën e fundit në të cilën Konventa hyn në fuqi për ato juridiksione kontraktuese";

